

**Raport vlerësimi**  
**në lidhje me aplikimin e Universitetit Kadri Zeka, Gjilan**  
**për akreditimin e programeve**  
**- Bachelor i Arteve në Shkenca Politike**  
**- Master i Shkencave në Ekonomi - Financa**

**26.03.2015**

**Ekipi vlerësues në përbërje të:**

- **Prof. Dr. Dr. h.c.mult. Reinhard Meyers, Universiteti Muenster (Gjermani)**  
**(Kryesues)**
- **Prof. Dr. Kristiina Tönnisson, Universiteti Tartu (Estoni)**

**Shoqëruar gjatë vizitës në terren:**

- **Prof. Dr. Ferdije Zhushi-Etemi, Kryetare, Këshilli Shtetror i Cilësisë/AKA**
- **Z. Fisnik Gashi, Zyrtar për vlerësim dhe monitorim, AKA**

**Baza e informacionit për Draft Raportin e Vlerësimit:**

- **Raporti vetëvlerësimit 2015, Universiteti Kadri Zeka, Gjilan, i datës 29.10.2014 [këtu e më tej citohet si RVV]**
- **Lista e personelit akademik për programet e cekura më lart (Listat e Universitetit dhe AKAsë)**
- **Raporti i Jashtëm i Vlerësimit, 2014**
- **Vizita në terren nga ekspertët e lartpërmendur në Gjilan, më 26.02.2015**
- **Materiali shtesë i kërkuar nga komisioni i ekspertëve pas vizitës në terren dhe i pranuar më postë më datë 06.03.2015.**
- **Komentet mbi Draft Raportin (jo Raportin Final, siç është deklaruar gabimisht nga UKZ-ja) nga Universiteti i Kadri Zeka datë 20.03.2015, të pranuar nga ekspertët përmes AKAsë me datë 21.03.2015.**

### **Qëllimet dhe objektivat:**

- Qëllimi i këtij raporti është që t'i mundësojë Agjencisë Kosovare për Akreditim dhe Autoriteteve ministrore apo/dhe politike të marrin një vendim në lidhje me akreditimin e programeve të lartpërmendura që do të ofrohen rishtazi nga Universiteti i Gjilanit. Ekspertët e nënshkruar do të vlerësojnë dokumentacionin e cekur më lart në dritën e përvojave të tyre të fituara në sistemet universitare gjermane, angleze, estoneze dhe franceze. Referencat për standardet dhe praktikrat e mira kryesisht i referohen sistemeve universitare gjermane dhe estoneze.

- Ky raport përmbillet me një numër të rekomandimeve në lidhje me secilin kurs të propozuar të programeve: ato janë mendim personal i autorëve dhe janë formuluar mbi bazën e sfondit të eksperiencave të lartpërmendura. Ato pasqyrojnë çfarë autorët konsiderojnë si të mirë apo praktika standardi në një numër të sistemeve arsimore të kryesisht Europës Perëndimore, pa dashur në asnjë mënyrë të paragjykojnë kufijtë e kushteve të ndryshme të edukimit terciar në Kosovë. Për këtë arsye, vendimi final për aplikacionin e Universitetit për akreditim të programeve të lartcekura duhet të merret nga autoritetet përkatëse të përfshira.

- Ky raport nuk kishte qenë e mundur të shkruhet në rend të parë pa përkrahjen e stafit të AKA-së, dhe gjithashtu të një numri të kontakteve sy me sy në Universitetin Kadri Zeka. Përderisa autorët janë më së mirënjohës për përkrahjen e pranuar, ata njëkohësisht duan të theksojnë që argumentet dhe përfundimet e këtij raporti janë përgjegjisi e tyre ekskluzive.

NB -Shënim (1): Sipas rregullave të zakonshme ndërkombëtare, emërtimi i këtij programi do të duhej të lexohej si: Master i Shkencave në Ekonomiks-Financa

NB-Shënim (2): rekomandimet në tekst janë shtypur *italics* ose gjenden në or are contained in separate boxes.

# I: Universiteti Kadri Zeka, Gjilan: STRUKTURA E PËRGJITHSHME DHE ORGANIZIMI

## **I.0 Hyrje, përshtypje paraprake**

Ekipi i Ekspertëve vizitoi Universitetin e Gjilanit më datë 26 shkurt 2015 dhe, pasi morën një hyrje të shkurtër në historinë e institucionit, zhvillimin e tij dhe llojshmërinë e tij të programeve, patën disa diskutime të detajuara së pari më zëvendës rektorin, Prof. Dr. Naim Syla dhe përfaqësuesit e menaxhmentit, më pas më anëtarët e stafit akademik përgjegjës për zhvillimin programeve akademike të cekura në fillim. Pas këto programe akoma nuk kanë filluar të ofrohen, nuk kishte takime me personelin mësimdhënës dhe studentët e programeve.

Fatkeqësisht, komentet e pranuar nga UKZ-ja mbi draft raportin nuk kishin prekur asnjë nga pikat që ekspertët i kishin bërë sy më sy strukturës së përgjithshme dhe organizimit të institucionit; për këtë arsye ekspertët marrin që vërtetimet e bëra nën I janë konsideruar nga UKZ-ja si adekuate dhe që i përshtaten gjendjes. Për këtë arsye ata nuk do të i ndryshojnë ato nga versioni fillestar të përfshira në draft raportin e tyre.

## **I.1 Deklarata e misionit**

Ekspertët vunë re që RVV-ja nuk përmban një kapitull të përgjithshëm rreth misionit dhe zhvillimit në të ardhmen të universitetit. Kjo, pjesërisht është zëvendësuar nga komentet e shkurtra në arsyetimin e secilit program nën mbishkrimet e programeve përkatëse. Ekspertët gjithashtu vunë re se universiteti kishte pranuar akreditim institucional në vjeshtë 2013-tës. Më këtë bien nga diskutimi një seri e pyetjeve përmbajtjesore, institucionale, financiare, të sigurimit të cilësisë, hulumtimit dhe stafit, që zakonisht janë kërkesa që lidhen me akreditimin institucional.

Gjithsesi, një numër më i vogël i pikave të ngritura gjatë vizitës në terren të cilat merituan analiza dhe diskutim, do të përmenden më poshtë.

## **I.2 Organizimi, menaxhimi dhe planifikimi; objektet, infrastruktura, pajisjet**

Ekspertët fillimisht nuk kishin ndonjë problem me mënyrën se si ishte administruar universiteti dhe as, si një rregull i përgjithshëm, me resurset dhe objektet e disponueshme për atë detyrë dhe për qëllime akademike.

Megjithatë, ekspertët me habi vërejtën mungesën e një zyre të rregullt për sigurimin e cilësisë ( RVV-ja flet në faqe 82 tutje për një zyrë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe cilësi, dhe përmend punën e zyrtarit të cilësisë pa dhënë më shumë se një pamje shumë të ngurtë të detyrave të tij/saj). Gjithashtu, në RVV ( fq. 82 e tutje) ka një përshkrim të shkurtër mbi procedurat e sigurimit të cilësisë, por nuk ka rregulla formale dhe rregullore në lidhje me kornizën e SC-së dhe procedurave të dhëna. AKA duhet të kërkojë më ngulm nga Universiteti për të përmirësuar në mënyrë drastike këtë gjendje brenda një afati të shkurtër.

U debatua gjithashtu baza empirike për futjen e programeve të reja të studimit, në veçanti, nëse universiteti kishte ndjekur politikë të orientuar nga oferta apo nga kërkesa dhe deri në çmasë ishin konsultuar apo kishin mundësi shprehje në procesin e planifikimit interesat e biznesit lokal, administratës dhe shoqërisë civile ; dhe deri në çmasë ofertat e reja për të cilat po kërkohej akreditimi do të plotësonin nevojat e tregut kombëtar të punës në Kosovë. Më sa doli nga përgjigjet nga pyetjet përkatëse, premisat që çuan në zhvillimin e sistemeve të programeve të reja ishin bazuar më parë në supozimet optimiste të universitetit se sa në faktet e hulumtimit të thellë të tregut lokal/kombëtar; nuk kishte informacione të besueshme as sa i përket punësueshmërisë e as mundësive të punësimit për të diplomuarit për programet e parapara.

### **I.3 Stafi**

Ekspertët vërejtën informacion minimal rreth stafit hulumtues dhe atij akademik siç është prezantuar në RVV, f. 76 e më tej. Kjo gjithashtu pengoi një diskutim më të detajuar rreth politikave të angazhimit të stafit siç kërkohet nga udhëzuesi i AKA-së për ekspertë. Gjithashtu, informacioni i dhënë mbi stafin në raportin e RVV-së dhe informacioni i stafit në listat aktuale të AKA-së në një numër rastesh nuk përputhej: në Gjilan vetë stafi qarkullonte mes angazhimit me orar të pjesshëm dhe orar të plotë, ndërsa në një numër rastesh ata mbanin angazhim me orar të plotë diku tjetër që parimisht do të përjashtonte punësimin e tyre me orar të plotë në Gjilan- sa për ilustrim: profesor me orar të plotë në Universitetin e Prishtinës, Ambasador i Kosovës në Austri, Ministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Në një rast tjetër, një anëtarë me orar të pjesshëm parashikohet të ofrojë një maksimum prej tre kurseve në javë dhe në të njëjtën kohë prezantohet me funksionin e tij rëndësishëm si sekretar i tretë në Ambasadën e Kosovës në Vjenë. Në komentet e tyre të draft raportit, Universiteti do të duhej të sqaroj këto përshtypje dhe të sigurojë një listë të besueshme finale të stafit në bashkëpunim me AKA-në.

- A ka institucioni proporcion adekuat të personelit të përhershëm dhe proporcion të duhur të personelit të përhershëm dhe personelit të jashtëm?

Lista e stafit akademik që i është dërguar ekipit të ekspertëve nga AKA-ja në të dy rastet një relacion prej 3 me orar të plotë kundrejt 11 ose 12 anëtarë të stafit me gjysmë orari; për më tepër, anëtarët me gjysmë orari japin deri në tre kurse në javë, përderisa ata me orar të plotë japin vetëm dy. Prandaj, numri i anëtarëve me orar të plotë dhe ngarkesës së tyre të mësimdhënies duhet të rritet në mënyrë domethënëse; numri i anëtarëve me orar të pjesshëm dhe ngarkesës së tyre me mësimdhënie duhet të zvogëlohet në mënyrë proporcionale.

- A demonstroi personeli akademik zotësi të dëshmuara në nivele të larta akademike dhe didaktike dhe a janë kualifikimet e tyre në përputhje me pozitën që ata mbajnë brenda institucionit sipas kriterit bazë?

Nga ana formale, të paktën në Departamentin e Ekonomiks, nga ana akademike stafi është i kualifikuar lartë; ata të gjithë kanë gradën PhD. Në Departamentin e Shkencave Politike numri i doktorantëve tejkalohet nga ata me grada master. Shumica e anëtarëve të stafit kanë eksperiencë të mire në mësimdhënie akademike, nëse mbështetmi në CV-të e tyre. Metodatat didaktike të përshkruara në kurrikulë tregojnë nivel të përshtatshëm të njohurive didaktike.

- A ka numër të njëjtë të femrave në personelin akademik/artistik?

Jo – padyshim që JO. Gjatë vizitës në terren, ekspertët takuan vetëm dy femra nga stafi akademik dhe pasi pyetëm menaxhmentin rreth mundësive të barabarta të punësimit, përgjigja ishte se nuk kishte mjaft femra me doktoratë në Kosovë në mënyrë që proporcioni të përmirësohej. *Ekspertët me këtë rast i rekomandojnë universitetit të filloj sa më parë një program të mundësive të barabarta gjinore; nëse vërtetë tregu i punës në Kosovë nuk siguron numrin e duhur të femrave të kualifikuara me doktoratë, universiteti duhet të punësoj dhe përkrahë në mënyrë domethënëse nga resurset e veta femrat që kanë gradën master, duke ju ndihmuar atyre të arrijnë nivelin e doktoratës si pjesë e punësimit të tyre.*

- A ka institucioni norma transparente, konkurruese dhe që kërkojnë cilësi për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit?

RVV në shtojcë paraqet një kontratë pune tipike e cila duket të jetë standarde në institucionet publike të Kosovës të edukimit terciar. Megjithatë, kjo nuk zëvendëson përshkrimin e detajuar të procesit të përzgjedhjes. *Këtë përshkrim, universiteti duhet jap shkurtimisht në përgjigjen e tij ndaj Draft Raportit të Vlerësimit.*

- A ka institucioni strategji zhvillimore që dëshmon se personeli i këtij institucioni mbanë në vazhdimësi standard të lartë?

Kjo pyetje vetëm u përmend shkurtazi gjatë vizitës; nuk ka informacion për zhvillimin e personelit në RVV. Marrë parasysh gjendjen e tregut të punës për akademik në Kosovë, AKA duhet të ngjis përshtypjen tek universiteti nevojën për një kualifikim gjeneroz të stafit brenda institucionit, në trajnime në vend të punës dhe politika për avancim. .

### Rekomandime:

1. *Më shumë strategji duhet të zhvillohen për rekrutimin dhe/apo zhvillimin stafit të ri akademik, dhe në veçanti për gratë. Ne rekomandojmë seminare të rregullta të llojit "të trajnosh trajnuesit".*
2. *Përzgjedhja e stafit akademik duhet të bazohet në kushte të përkufizuara qartë, sa i përket gradave akademike, kualifikimeve didaktike, përvojës në mësimdhënie, publikime, rezultate kërkimore, etj.*
3. *Më qëllim që procedurat e përzgjedhjes për emërimet profesionale të sillen në nivelin e standardeve të krahasueshmërisë ndërkombëtare, ekspertët sugjerojnë që të paktën një anëtarë nga secili komision përzgjedhës duhet të vijë nga jashtë – d.m.th. ose nga një universitet apo institucion tjetër kosovar i arsimit të lartë, apo nga një institucion i krahasueshëm nga jashtë.*
4. *Një version i konsoliduar dhe i përditësuar në vazhdimësi i Politikave për Zhvillimin e Personelit duhet ta shoqëroj çdo RVV si shtojcë që jep informacionin e plotë për zhvillimin e stafit në mënyrë që ekspertët të kenë një pasqyrë më të plotë rreth situatës me stafin pas vlerësimit të RVV-së.*

## 1.4 Financat dhe objektet, infrastruktura dhe pajisjet

### Expertët adresuan pyetjet në vijim sa i përket këtij kreu:

- A ka institucioni buxhet adekuat dhe resurse të mjaftueshme financiare?

Përgjigja e kujdesshme është po- buxheti i Universitetit është pjesë përbërse e buxhetit të qeverisë së Kosovës dhe si i tillë subjekt i kufizimeve dhe hapjeve të përgjithshme që përcjellin ushtrimin/ zbatimin e këtij buxheti. Si në të gjitha institucionet me buxhet publik, planifikimi afatmesëm i shpenzimeve nuk janë bërë shumë të dukshme në RVV.

- A ka institucioni ndërtesa adekuate dhe infrastrukturë të specializuar përsa i përket nevojave të programit akademik që ofrohet dhe hulumtimeve që do të zhvillohen (biblioteka, kompjuterë, laboratorë)?

Përgjigja sërish është po, nëse kihet parasysh lokacioni i tanishëm i universitetit në qendër të qytetit (edhe pse atmosfera e tij më shumë të kujton një gjimnaz më traditë) i vetmi përjashtim është biblioteka dhe numri i zyrave/ kabineteve për stafin e përhershëm akademik; këta të fundit sigurisht që do të dëshironin të rritej numri i tyre!

## **I.5 Menaxhimi i Cilësisë dhe administrimi i ECTS-ve**

Mekanizmat e cilësisë dhe menaxhimit të ECTS-ve, të përshkruara shumë shkurt në RVV, nuk kënaqën ekspertët ( shih me lartë 1.2). AKA-ja duhet të imponoj në universitetet domosdoshmërinë e menaxhimit transparent, të formalizuar dhe efektiv të cilësisë me personel të mjaftueshëm dhe resurse të ndara financiare. Sigurimi i cilësisë dhe planifikimi për të ardhmen duhet të ecin paralelisht. Në përgjigjen e tyre në Draft Raport, universiteti për këtë arsye duhet jo vetëm të jap një prezantim të qasjes së tyre të vlerësimit të cilësisë, por gjithashtu të përshkruaj në formë më të përgjithshme procesin e tij të planifikimit.

## **1.6 Programet akademike dhe menaxhimi i studentëve**

Pyetjet në vijim janë adresuar nga ekspertët gjatë vizitës në terren dhe në përgatitjen e draft raportit mbi bazën e dorëzimeve të ndryshme të pranuar nga universiteti:

- A korrespondon programi akademik me misionin e institucionit dhe parimete punësimit?
- A është cilësia, niveli dhe synimet akademike të këtij programi në përputhje me gradën akademike?
- A është programi i bazuar kryesisht në konceptin didaktik që është paraqitur dhe adoptuar në mënyrë adekuate nga personeli mësimdhënës?
- A korrespondojnë gradat akademike me standardet ndërkombëtare?
- A jep struktura e programit mundësi të mjaftueshme për studime, reflektime dhe analiza të pavarura? (p.sh. çfarë është proporcioni i kohës së studimeve të pavarura krahasuar me njësitë në klasë?).
- A është vendosja ECTS-ve e duhur dhe e arsyetueshme?
- A është ngarkesa e punës që është e domosdoshme për programin akademik e menaxhueshme nga studentët?
- A janë metodat dhe përmbajtja e njësive mësimore të mjaftueshme për arritjen e suksesshme të synimeve dhe rezultateve të secilit program (kompetencat dhe kualifikimet, njohuritë dhe aftësitë)?
- A janë të përshtatshme rregulloret e provimeve?
- A është përmbajtja e përbashkët akademike mes kurrikulave të ndryshme e kuptueshme dhe transparente?
- Në çfarë niveli të standardëve ndërkombëtare janë kriteret dhe procedurat e regjistrimit?
- A janë në proporcion të duhur personeli akademik/artistik me studentët?

Pasi që këto pyetje më së miri mund të përgjigjen mbi bazën e programeve individuale, ato do të formojnë skeletin për vlerësimin individual të programeve. Përgjigjet për këto pyetje, pra mund të gjeten nën mbishkrimet për programet individuale që kanë aplikuar për akreditim.

## **I.7 Studentët**

Nuk kishte takim me studentët pasi programet për akreditim ishin programe të reja.

## **I.8 Hulumtimi**

Pikat në vijim janë diskutuar gjatë vizitës në terren dhe janë përmendur shkurtazi më pastaj mes ekspertëve në përgatitjen e draft raportit:

- Çfarë janë pritjet e hulumtimeve nga institucioni dhe si lidhen ato me numrin dhe cilësinë e stafit të tij të përhershëm?

Janë përmendur dy projekte të mundshme hulumtimi në RVV; Two possible research projects were mentioned in the SER; nuk duket të jetë arrirë ndonjë përparim i dukshëm deri më tani.

- A është i përfshirë personeli mësimdhënës në aktivitete hulumtuese brenda ose jashtë institucionit, dhe a kanë efekte këto aktivitete hulumtuese në përmbajtje të mësimdhënies /kursit?

Nuk është dhënë ndonjë informacion bindës në RVV që mundëson përgjigjen në këtë pyetje; për ta bërë këtë do të ishte e nevojshme të analizohej në tërësi secila CV pasuar nga intervistat eksploruese . Ekspertët sugjerojnë që në RVV e radhës duhet të ketë së paku një pasqyrë tabele informative për projektet hulumtuese individuale të stafit dhe ndikimit të tyre për mësimdhënien në Gjilan.

- A janë të përfshirë studentët në projektet bashkëpunuese dhe hulumtuese?

Në parim krahaso deklaratën pak më lart. Në çfarë niveli kjo përfshirje ka qenë frytdhënëse mund të vlerësohet vetëm mbi bazën e materialit të përmendur në paragrafin pararendës. AKA-ja duhet të pyes në mënyrë të veçantë ekipin e ardhshëm të ekspertëve që të kontrollojnë këtë aspekt.



## **I.9 Kontaktet e jashtme dhe bashkëpunimi ndërkombëtar**

Në materialin shtesë të dërguar përmes e-mailit, universiteti ka paraqitur një listë me afërsisht gjysmën e saj me një duzinë të partnerëve bashpunëtorë rajonal, dhe gjithashtu përmenden gjashtë projekte bashkëpunimi të parashikuara në shkallë ndërkombëtare. Pasi këto akoma janë në progres, nuk mund të jepet një vlerësim me i saktë për suksesin e tyre për momentin. RVV-të e ardhëm duhe të kenë një kapitull për projektet hulumtuese aktuale dhe të përfunduara, si dhe rezultatet e tyre.

Pyetjet tjera për t'u adresuar janë:

- A është adekuat niveli dhe cilësia e bashkëpunimeve ndërkombëtare në hulumtime dhe mësimdhënie?
- A janë të përshtatshme strategjitë e ndërkombëtarizimit dhe përfshirjes së stafit dhe studnetëve në bashkëpunimet e trajnimeve dhe programeve të mobilitetit?
- Si e përcakton universiteti nivelin e përshtatshmërisë në të dy rastet?

## **I.10 Pika të veçanta problemi: Biblioteka**

Eskpertët vizituan librarinë gjatë inspektimit që i bënë objekteve dhe vërejtën që ka nevojë për më shumë hapësirë; veçanërisht, nëse dhe kur edhe rreth 150 studentë do ta përdorin atë në rast të akreditimit të mundshëm të programeve të reja. Shumica e posedimeve të librarisë ishin libra nga fusha e Edukimit dhe Studimeve Juridike (gjë për të cilën ka një shpjegim kur kihet parasysh historia e Universitetit të Gjilanit). Ekspertët nuk mundën të dallojnë nëse kishte një ndarje të qartë ndërmjet librave të mësimin për studentët dhe bibliotekës për hulumtime, dhe nëse kjo e fundit ishte e organizuar në a) bibliografi, b) vepra reference, c) publikime zyrtare, d) literaturë e botuar sekondare, e) manualë dhe revista shkencore, f) materiale të përgjithshme leximi të karakterit jo shkencor, g) material i ruajtur në formë elektronike. Biblioteka më sa duket funksionon akoma me indeks dosje-karte; personeli linte një përshtypje të qasshme, të dobishme dhe miqësore. Nuk kishte kohë të mjaftueshme për të kontrolluar një sugjerim nga raporti i ekspertëve nga vitit të kaluar- d.m.th. që së paku një kopje e gjithë literaturës së rekomanduar për lexim e cekur në përshkrimin e kurseve duhet të jetë prezentë në bibliotekë. Universiteti mund të adresojë këtë çështje në komentet e tyre në Draft Raport.

Mbi bazën e përvojës së tyre të fituar gjatë vizitës në terren, dhe mbi bazën e përvojave të përgjithshme të fituara gjatë vizitave të mëhershme në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, ekspertët rekomandojnë si në vijim:

**Rekomandime fillestare:**

- të strukturohet biblioteka si biblioteka me tekste mësimi që i përshtatet nevojave të mësimi akademik në fushat e drejtimeve të Univesitetit
- të investohet në vazhdimësi në përvetsimin e librave mësimor në bashkëpunim dhe në pajtim me nevojat e fushave të lëndëve individuale
- të jenë të disponueshme vepra të mëdha ( veçanërisht vepra reference, fjalorë, tekste juridike dhe publikime të dokumentëve zyrtare) në CD-Rom

### 1.11 Reflektime përfundimtare për pjesën e përgjithshme të Raportit vlerësues

Më fjalë të tjera:

- librat e mësimi dhe literatura kërkimore duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra; derisa literatura kërkimore mund të mbahet e mbyllur në vitrinat që janë, tekstet mësimore ( librat e mësimi) duhet të jenë të qasshëm lirshëm në raftet në dhomën e leximit të bibliotekës bashkë me veprat e referencës, fjalorët e gjuhëve, bibliografitë dhe të ngjashme.
- Në hapësira e rafteve në sallën e leximit nuk është e mjaftueshme të mbaj të gjitha ato që u përmenden, të ndahen koleksionet në a) arte dhe shkencë sociale, b) juridik dhe ekonomiks, c) Edukim, d) Shkencë Natyrore dhe Matematikë dhe ndani nga një sallë leximi për secilin grup.
- Tekstet e mësimi – dhe eventualisht gjithashtu literatura hulumtuese (kërkimore) – duhet të klasifikohen sipas lëndëve dhe të rendisen mbi bazën e parimit të përkatësisë: -p.sh librat me lëndë të përafërta duhet të qëndrojnë në raftet në grupe pranë njëra tjetrës, që p.sh vëmendja e studentit nga e drejta private ndërkombëtare të tërhiqet edhe të tekstet mësimore nga e drejta ndërkombëtare publike, etj.

Komisioni i ekspertëve gjithashtu shtroi idenë nëse mangësitë e dukshme të librarisë fizike (të shtypur) mund të zbuteshin ose edhe mbase të tejkalohen përmes ndërtimit të një bibliotekë elektronike. Sidomos në shumë nën-fusha të Juridikut dhe Ekonomiks një numër i madh i teksteve publikohen në format elektronik; për këtë arsye një qasje me e madhe në media elektronike, një bibliotekë e shtesë reference dhe një koleksion i librave të tanishëm në juridik, ekonomiks, shkencë informative, politika dhe administratë publike, si dhe në Studime Europiane dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare do të mund të konsiderohej si bazë më e vlefshme për universitetin se sa përmbledhja aktuale fizike.

**Rekomandim tjetër:** në planin afatmesëm, do të paguhej-në mënyrë metaforike- nëse universiteti punëson për ca kohë dy apo tre studentë si asistentë kërkimor puna e të cilëve do të ishte të hulumtojnë internetin për uebfaqe me referenca ( si p.sh. *Stanford Encyclopedia of*

*Philosophy - <http://plato.stanford.edu/> ), programe e-learning, faqe shkarkimi të instituteve kërkimore (si ARENA, Crisis Web, HSFK, Brookings Institute etj., etj) dhe think tanks të politikave, dhe shkarkohen uebfaqet e organizatave qeveritare dhe jo qeveritare ( që nga KB të BE-ja e deri p.sh OXFAM) me qëllim të ngritjes së një katalogu me linçe për dokumente specifike, publikime zyrtare dhe gjysëmzyrtare dhe material studimor që do të ishte i disponueshëm në serverin e fakultetit për të gjithë studentët dhe që do të mund të kopjohej në Cd ose USB dhe të merret me vete në shtëpi. Kjo nuk tejkalon mungesën e librave fizik, por të paktën e zbut atë pak.*

### **I.11 Pika të veçanta problemi: progresi nga raportet e mëhershme të vlerësimit**

Deri më tani informacioni mbi progresin e bërë nga Universiteti në lidhje me rekoamndimet e mëhershme të ekspertëve ( Raporti i Vlerësimit i vitit 2014) ashtu si është pranuar në komnetet UKZ-së në draft raport dhe korrigjuar nga lista e përmbajtur në vitin e 2015-tës ff 96 – 100 ishte mjaft i dobët. Në thelb, UKZ pretendon se ata kanë për të ngritur një institut të Shkencave Politike deri në shtator të 2014-tës [ i cili nuk u ishte treguar ekspertëve me rastin e vizitës në terren si një entitet fizik, kështu që vlefshmëria i kësaj deklaratë nuk mund të konstatohet], se ata kanë përfshirë një numër të stafit mesimdhënës ndërkombëtarë me qëllim që të garantojnë nivel të lartë arsimi, hulumtimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe se ata janë në kontakt me profesorë ndërkombëtarë (??) që do të japin mesim në Gjilan.

Fatkeqsisht, në lidhje me dy pretendimet e fundit, në komentet e draft raportit as nuk janë dhënë emrat e kandidatëve të mundshëm që dëshirojnë të japin mesim apo të bëjnë vizita hulumtuese, as nacionaliteti i tyre dhe përkatësia institucionale, as fusha e tyre akademike individuale. Prandaj, ekspertët duhet të konkludojnë që këto pretendime janë vetëm të karakterit sa për të larë gojën dhe se UKZ-ja duhet të kalojë edhe shumë rrugë para se rekomandimet e vitit 2014 të mund të konisderohen në ndonjë mënyrë si të përmbushura.

## II KURSET DHE PROGRAMET PËR AKREDITIM

### II.1 Bachelor i Arteve në Shkenca Politike

Universiteti aplikon për akreditimin e një programi Bachelor tre-vjeçar standard në Shkenca politike, gjashtë semestra me kohë të plotë, 180 ECTS në total, 60 ECTS/vit. Programi bachelor në Shkenca Politike, ofron 75 vende studimi për vit në tarifa të moderuara. Formalisht, ky program përmbush kushtet e marrëveshjes së Bolonjës (në strukturën 3+2+3) dhe është rrjedhimisht i krahasueshëm në parim me skema kursesh të ngjashme në zonën e Bolonjës. Përshkrimi i programit është informativ, përmban pikat standarde të zakonshme, procedurat e vlerësimit dhe rregulloret për draftin e tezës përfundimtare të Bachelorit. Programi ofron kurse në fushat e mëposhtme (RVV, fq. 99 e në vijim)

1. Filozofi politike
2. Metoda të hulumtimit social
3. Politikë e krahasuar
4. Politikë publike
5. Marrëdhënia ndërkombëtare dhe diplomaci
6. Ekonomi politike ndërkombëtare
7. Anglisht

Siç mund të shihet nga kjo dhe nga një analizë më e afërt e silabusit të kursit RVV, fq. 26 e në vijim, ndarja e lëndëve është shumë konvencionale, tradicionale, duke qenë shuam mbrapa Shkencave Politike moderne që kanë lënë si të tejkaluar ndarjen statike trepalëshe në Teori politike, Qeverisje e krahasuar dhe Politikë ndërkombëtare, kohë më parë dhe ka ndryshuar drejt një perspektive të orientuar te procesi mbi politikat në kornizën e një organizate politike, ose edhe ka krijuar ura mes kufijve klasikë mes tre fushave të përmendura nga përshtatja e një perspektive për qeverisjeje me shumë nivel, gjë që jo vetëm lejon të ndiqet axhenda, artikulimi i interesave, vendim-marrja dhe vendimi të zbatohet lirshëm nga poshtë në sistemin global të botës dhe e anasjelltas, por gjithashtu lidh kufijtë konceptualë mes vetë Shkencave politike, Sociologjisë politike, studimeve për Sjelljen politike dhe aspekteve funksionale dhe normative të ndërveprimit dhe bashkëpunimit njerëzor. Sigurisht, UKZ ka shumë të drejtë të pretendojë se ata këmbëngulin në idenë tradicionale të Shkencave Politike BA për arsye didaktike – por atëherë ata gjithashtu do të përdornin didaktikën e 1970-ës dhe 1980-ës. Fakti që ka tekst (dhe rrjedhimisht edhe plane kursesh) që inkorporojnë më shumë perspektiva moderne të përmendura më sipër demonstron në mënyrë të gjallë nga Andrew Heywood (Politika, 2013; Politika globale, 2014; Teoria politike, 2015.)

Përshtypja tjetër e përgjithshme për programin është se ai nuk jeton sipas rolit dominant që Bashkimi European luan për Kosovën në veçanti dhe për Ballkanin perëndimor në përgjithësi: ka një kurs mbi Integrimin evropian në semestrin 5 dhe një tjetër mbi Politikën dhe politikëbërjen në BE në semestrin 6. Ajo që mungon vendosmërisht janë modulet më intensive në:

- Institucionet e BE, roli i tyre, kompetencat, mënyra e punës dhe rezultatet
- Përzgjidhni zonat e politikës së BE-së (p.sh. politika bujqësore ose mbrojtja e konsumatorit) dhe format respektive të ligj-bërjes në këto fusha – në fund të fundit ne kemi më shumë se 40 forma të ligj-bërjes në BE sipas fushës së problemit
- Ligji i Bashkimit European dhe mënyra se si ai është formuluar dhe administruar
- Krijimi i axhendës dhe përfaqësimit të interesave në Bruksel dhe roli i organizatave të sektorit të tretë
- BE si një faktor i jashtëm, Politikën e përbashkëta në politikën e jashtme dhe të sigurisë, Politika e zhvillimit dhe roli i saj përballë botës së tretë
- Europeanizimi i politikave kombëtare (p.sh. influenca e BE-së në politikën e shteteve anëtare) dhe anasjelltas – influenca e shteteve anëtare në politikën e BE-së.
- Politikën rajonale dhe strukturore, rëndësi dhe puna e Fondit të Kohezionit, roli i Marrëveshjeve të Stabilizimit dhe Asociimit, etj., etj..

Nga pikëpamja e faktit se një pjesë e madhe e shpenzimeve publike të Kosovës financohet nga donatorët e BE-së të përshkrimeve të ndryshme, edhe administratorët lokalë duhet të kenë një njohuri tërësore të mënyrës se si punon Brukseli, opinionet që jep dhe kartat që ai ofron për lojën e tyre! Kështu që përfundimi logjik do të ishte rritja e përmbajtjes evropiane në programin BA. Pretendimi që dy kurset e përmendura të BE-së mund të mbulojnë të gjitha aspektet e mësipërme në detaje domethënëse, siç pretendon UKZ në komentin e tyre në Draft është shumë i hapur ndaj dyshimit. Megjithatë, nëse ju keni zgjedhur një program të Politikës shumë konvencional dhe të bazuar te shteti, atëherë këto lëndë dhe fusha problemi e humbasin rëndësinë e tyre: nëse politika është ajo çka bën shtet, për të perifrashuar një parim konstruktivitet, ju mund të injoroni shumë nga BE-ja, megjithëse në rrezikun tuaj.

Përshtypja përfundimtare e përgjithshme e programit përmban një mungesë përputhshmërie midis arsytimit për tregun e punës (RVV, fq. 16), të diplomuarve që shpresojnë të prodhojnë dhe lëndëve që ofrohen në të vërtetë. Programi synon të prodhojë:

- Profesionalë me etikë dhe njohuri të larta politike dhe civile për sektorët e shërbimit publik si institucione qeveritare, shërbime të huaja, ambasada dhe parlament
- Profesionalë me etikë të lartë politike dhe civile, njohuri dhe aftësi për punë në media
- Profesionalë me etikë të lartë politike dhe etike, njohuri dhe aftësi për të punuar në OJQ
- Profesionalë për punë me sektorët privatë; profesionalë për punë me organizatat ndërkombëtare
- Profesionale me synimin e ndjekjes së nj karriere akademike

**Shënim** - Në këtë listë mungojnë politikat lokale, administratat lokale dhe rajonale dhe ndoshta edhe shërbimet publike lokale dhe rajonale...

Fjala kyç e kësaj është administrata; megjithatë, për punën me mediat, OJQ-të dhe organizatat e sektorit të tretë private/gjysmë private, programi nuk ka shumë për të ofruar. Në këtë kontekst do të ishin të pritshme module mbi

- Krijimin e axhendës, vendimmarrja, zbatimi i politikave dhe kontrolli i rezultatit (juridik) në qeverisje me shumë nivele
- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe zhvillimi i lidershit potencial
- Agregimi i interesit, lotimi dhe fushata publike
- Financa publike, buxheti dhe auditivi
- Ligji konstitucional dhe administrativ

Draft raporti përmban një rekomandim opsional lidhur me një zgjidhje të mundshme për programin BA të sugjeruar, i cili në këtë formë përpiqet të vrasë një numër shumë të madh zogj të tregut të punës vetëm me një numër të kufizuar gurësh. Megjithatë, në komentin mbi Draftin, UKZ preferon të mos e konsiderojë këtë, duke preferuar një organizimi shumë të gjerë trepalësh që përfshin gjithçka në skemën e kursit. Kjo do të na sjellë tek një nga shumë pikat mbi të cilat ky vlerësim është bazuar përfundimisht:

Problem partikular hapësirë- staf:

Përmbledhja origjinale e programit BA të dhënë në RVV fq. 24 e në vijim ishte e prekur nga një deficit masiv në personel: nga 30 kurse gjithsej, 9 nuk llogariteshin ë termat e personelit mësimor. Pasi u tërhoq vëmendja në këtë fakt gjatë vizitës në terren, organizatorët e programit prodhuan, me kërkesë të ekspertëve, një listë të përditësuar të stafit mësimor, gjë që plotësoi shumë hapësira të bardha. Se deri në ç' masë kjo listë përfaqëson gjendjen e vërtetë kontraktuale do të vërtetohej nga AKA; gjatë vizitës në terren, si dhe në shtojcën e komentit të tyre mbi Draftin, eksperteve nuk iu dha asnjë

para-kontratë me anëtarë të ardhshëm të stafit. Rrjedhimisht, mbeten disa vëzhgime dhe pyetje të mistershme:

a) Proporcioni staf me orar të pjesshëm/staf me orar të plotë: ka 10 persona me orar të pjesshëm, 3 me orar të plotë dhe tre anëtarë të stafit mbi të cilët nuk kishte asnjë informata të mëtejshme (ndër ta, për fat të keq, personi që supozohet të japë kurset e BE-së). Një nga tre mësuesit me kohë të plotë listohet si Ambasador i Kosovës në Austri, një tjetër mban një pozicion me orar të plotë në Departamentin e Ekonomisë (dhe jep dy kurse të detyrueshme të Ekonomisë në Departamentin e Politikës), dhe tjetri në pozicion me orar të plotë jep Të Drejtën në U. e Prishtinës (dhe dy kurse për E drejta publike ndërkombëtar në Gjilan).

b) ngarkesa mësimore shumë e madhe për stafin me orar të pjesshëm: 4/5 e të gjitha kurseve në Departamentin e Politikës jepen nga stafi me kohë të pjesshëm (në një sërë rastesh deri në tre kurse për kolegë me kohë të pjesshëm!). Dhe: kolegu përgjegjës për zhvillimin e programit është me kohë të pjesshëm, gjithashtu.

c) mundësitë e pabarabarta të punësimit: vetëm një numër shumë i kufizuar i stafit mësimor perspektiv janë femra.

E gjithë kjo nuk është një situatë praktike e stafit dhe ekspertët do të rekomandonin AKA-në të investigim nëse kjo sipas kërkesave të tyre kontraktuale dhe mësimdhënëse apo jo.

### **Vërejtje mbi modulet individuale të kurseve:**

Në termat e përshkrimit të përmbajtjes, objektivat e kursit dhe rezultatet mësimore përshkrimet e moduleve individuale ishin përgjithësisht të qarta, të gjithanshme dhe të rregullta; në disa raste, megjithatë, literatura mund të ishte e rifreskuar dhe e përditësuar. Kjo vlen veçanërisht për

- Hyrje në MN (shto Baylis.Smith në literaturë)
- Hyrje në Politikë të krahasuar
- Hyrje në Ekonomi
- Teoria e Politikave të krahasuara
- Tranzicioni dhe demokratizimi në Ballkan
- Ligji publik ndërkombëtar
- Integrimi në BE (Helen Wallace et al., Neill Nugent)]
- Administratë publike

Është dhënë më shumë informacion mbi botime më të fundit në Draft Raport, seksioni Biblioteka, krahaso me lart I.10. I.10

**Rekomandim për AKA-në:**

**Universiteti ka bërë progres që nga Raporti i vlerësimit 2014. Megjithatë në Shkencat Politike ka ende një rrugë të gjatë derisa të arrihet synimi i një program BA modern, ndërkombëtarisht konkurrues dhe të orientuar nga tregu i punës që mund t'i mbijetojë konkurrencës kombëtare dhe ndërkombëtare. AKA duhet të ftojë Universitetin të ridorëzojë një aplikim të ripunuar për akreditimin e një program të tillën në kohën e një viti, duke marrë parasysh rekomandimet e dhëna në këtë raport.**

## II.2 Master i Shkencës në Ekonomi- Financë

### *i. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve*

#### II.2 MSc në Ekonomi - Financë

Programi i propozuar MSc në Ekonomi - Financë do të ishte pa a shumë një vazhdim direkt nga programi BA në *bankë, financë dhe kontabilitet* dhe një vazhdimësi indirekte për 1) BA në *marketing* dhe 2) BA në *menaxhim dhe informatikë*. Këto programe sapo janë hapur këtë vit akademik në Universitetin "Kadri Zeka" (UKZ). Programet janë dhënë më parë në të njëjtat premisa, por përpara krijimit të UKZ-së jepeshin brenda degëve të Universitetit të Prishtinës në Gjilan. Aktualisht ka rreth 800 studentë (sipas AKA-së numri ekzakt është 782 studentë) që studiojnë këto programe (në *bankë, financë dhe kontabilitet* 325 studentë, në *marketing* 155 studentë dhe në *menaxhim dhe informatikë* 302 studentë).

Kurrikula e MSc përpiket të mbulojë si temat e ekonomisë, ashtu edhe temat e financës ndërsa i ofron studentëve mundësinë të vazhdojnë arsimin e tyre në nivel MSc pasi marrin diplomën BA në fusha të ngjashme. Megjithatë, fokusi i programit nuk është shumë i qartë. Nga njëra anë programi fokusohet në ekonomi dhe financë, nga ana tjetër argumentimi në raportin vetë-vlerësues/takime theksoi kryesisht nevojat e biznesit në Kosovë, duke parë më shumë drejt MBA klasik. Duke parë silabusin e kursit, shumica e kurseve/materialeve për lexim kërkojnë njohuri paraprake të mirë vendosura për fushën (p.sh. Njohuri e avancuar në Ekonomi, por mund të jetë e vlefshme për ta hapur programin për të tjerët, gjithashtu. Personeli akademik vuri në dukje se masa e studentëve potencialë vjen nga një popullsi 300'00-400'000 (që



mbulon bashkitë e Gjilanit, Kamenicës, Vitias, Ferizajt, Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës).

Është po ashtu pak konfuze deklarata e plotë rreth arsytimit të programit për tregu ne punës (2.2.7, fq. 65), p.sh. "Me përfundimin e këtij programi, studentët do të përftojnë aftësitë e nevojshme për t'u bërë lider transformues në një ekonomi." Në të njëjtën kohë thuhet (2.1) se programi i drejtohet studentëve që janë të interesuar në hulumtim shkencor". Kësisoj, nuk është e qartë nëse programi është më afër me një program ekzekutiv/të aplikuar apo me një program shkencor me bazë hulumtimin. Gjithashtu, reagimi nga profesorët gjatë intervistave nuk dha një mesazh të qartë se në cilën mënyrë dëshironin ta shihnin programin ata, si mund të përshkruhej fokusi i kurrikulës dhe cili mund të ishte PUSH (propozimi unik i shitjes) i programit që nuk e ka asnjë program i ngjashëm rreth e rrotull (për fat të keq, personi që ishte më parë përgjegjës për zhvillimin e kësaj kurrikule nuk mundi të ishte i pranishëm gjatë takimit).

Programi përbëhet nga 120 kredite ECTS dhe vetë teza ka 30 ECTS. Cilësia, gama dhe qëllimet e programit janë të përshtatshme për një gradë të tillë akademike (MSc). Edhe nëse programi nuk është i bazuar në një koncept didaktik (nuk kishte asnjë koncept konkret që do të ndiqte programi duke marrë parasysh se shumica e leksioneve mbahen para nj audience të madhe), mësuesit janë ende të vetëdijshëm për qasjet e mundshme dhe të ndryshme kundrejt mësimdhënies. Sipas intervistave me stafin akademik, mësuesit përdorin shpesh shembuj nga jeta reale dhe raste studimore.

Sipas standardeve ndërkombëtare, struktura e programit duket e përshtatshme. Gjatë takimit nuk ishte mjaftueshëm e qartë se sa UKZ i kushton vëmendje pyetjes se si të ulë mbivendosjen e përmbajtjes akademike mes programeve BA dhe MSc. RVV deklaroi (fq. 65) se "studentët do të ndërtojnë aftësitë e menaxhimit dhe njohuritë në ekonomi për të fituar përvojë dhe për ta aplikuar këtë në një mjedis të ndryshëm, duke mundësuar përjetimin e një ndikimi të menjëhershëm". Së pari, programi nuk përfshin asnjë praktikë dhe kjo është arsyeja se pse mund të jetë e vështirë pasja e një "ndikimi të menjëhershëm". Eksperti sugjeron konsiderimin e këtij aspekti ehe një herë tjetër (duke futur praktikën në kërrikull). Së dyti dhe një aspekt akoma më i rëndësishëm është përmbajtja e kurrikulës/ mbulimi i kurseve - cilat njohuri, aftësi mësohen në këto kurse. Aktualisht nuk ka kurse të buta brenda kurrikulës, p.sh. kurse mbi lidëshipin, inovacionin, menaxhimin e burimeve njerëzore, përgjegjësinë sociale, etikën e biznesit, marketingun, etj.. Kjo është e papërshtatshme dhe nuk merr mjaftueshëm në konsideratë se për çfarë aftësish dhe njohurish do të kenë

nevojë njerëzitet në tregun e punës, ndërsa punojnë për ekonominë dhe financën. Gjysma e kurseve kanë të njëjtin emër si në studimet BA, por thjesht përfshijnë “nr. 2” në titull, p.sh. Financë publike 2, Menaxhim kontabiliteti 2, Financë e korporatës 2 etj..

Proporcioni i studimeve të pavarura krahasuar me njësitë e klasave nuk është ende i qartë. Struktura e programit mund të mos japë mundësi të mjaftueshme për studim të pavarur, reflektim dhe analizë. Megjithatë, është shuam herët për të gjykuar duke qenë se përshkrimi i secilit kurs është një deklaratë e përgjithshme me “fjalët kyçe korrekte” pa dhënë një përmbledhje të asaj se çfarë planifikohet të ndodhë në fakt gjatë kursit.

Duke parë kurrikulën aktuale, kurset janë ekstremisht të standardizuara. Thuajse të gjitha kurset kanë të njëjtat metoda vlerësimi (jo thjesht metoda, por edhe të njëjtat përqindje): një ese hulumtuese (50%) dhe një provim (50%). Kjo mund të lerë përshtypjen se paketimi i kurrikulës është punuar pa konsideruar mjaftueshëm përmbajtjen/specifikat reale të kursit/kurrikulës (didaktikë, ngarkesë, kritere vlerësuese të ndryshme). Të gjitha kurset e detyrueshme do të kenë 8 ECTS dhe të gjitha kurset me zgjedhje do të kenë 6 ECTS. Duke parë silabusin aktual, përshkrimet e kursit dhe materialet për lexim nuk ka lidhje të qartë mes sasisë të materialeve për lexim/detyrave të shtëpisë/orëve të punës dhe kreditove të dhëna (edhe nëse në dokumente është thënë qartë se sa punë mbulon çdo kredit, silabusi i kursit nuk e reflekton këtë). Kësisoj, nuk është e qartë se pse disa kurse kanë më shumë kredite se të tjerat. Ky aspekt duhet të silltet në hartimin e kurrikulës në një mënyrë më të qartë. Ngarkesa e kërkuar e punës për programin akademik mund të konsiderohet si e menaxhueshme për studentët. Aktualisht nuk është planifikuar asnjë kurs që do të jepet në anglisht. Eksperti sugjeron t’i kushtohet më shuam vëmendje rritjes së njohurive dhe përdorimit të anglishtes në procesin mësimor.

**Rekomandime:**

**Kriteret e vlerësimit të kurseve, orëve në klasë, korrelacionit mes ECTS dhe ngarkesës së punës duhet të paraqiten në një mënyrë më të qartë. Nuk këshillohet pasja e një qasjeje kaq fuqishëm të standardizuar në të gjitha kurset. Aktualisht janë listuar vetëm tekste, si material leximi. Sugjerohet të konsiderohen gjithashtu artikuj shkencorë nga gazetatat si material leximi duke qenë se njohuritë e reja, relevante dhe të përditësuara jepen më shumë përmes artikujve se sa përmes librave. Këshillohet gjithashtu që disa nga kurset/ disa pjesë të kurseve të jepen në anglisht. Shkolla duhet të kërkojë mundësi për praktika lokale/ndërkombëtare dhe projekte hulumtuese lokale/ndërkombëtare ku studentët mund të marrin pjesë dhe të fitojnë përvojë të vlefshme praktike. Sugjerohet gjithashtu që lektorët nga vende të huaja të ftohen për të marrë pjesë në program.**

## *ii. Stafit*

Aktualisht nuk ka proporcion të përshtatshëm mes stafit të përhershëm dhe stafit të jashtëm të planifikuar për mësimdhënien e kësaj kurrikule në UKZ. Në letër të gjitha kurset planifikohen të mbikëqyren nga persona me PhD dhe profesorë. Kualifikimet e tyre janë të përshtatshme për pozicionet që ata mbajnë brenda institucionit sipas kriterëve. Stafit mësimor që eksperti mundi të takonte gjatë vizitës në terren ishte shumë kompetent dhe tepër i motivua për të filluar zbatimin e kurrikulës.

Bazuar në të dhënat e RVV-së, ka 15 persona përgjegjës për 15 kurse. Nga këta 15 profesorë, vetëm 3 janë profesorë me kohë të plotë dhe të gjithë të tjerët planifikohet të kenë pozicione me kohë të pjesshme në UKZ. Bazuar në informacionin shtesë të marrë nga AKA-ja, 8 profesorë punonin me kohë të plotë në Universitetin e Prishtinës, 4 prej tyre punojnë me kohë të pjesshme në Kolegjin Iliria dhe 2 për Kolegjin AAB. Prof. Lufti Zharku që listohet si profesor me kohë të plotë në RVV punon tashmë si Ministër në Qeverinë e Kosovës, ndërsa ka gjithashtu dy pozicione me kohë të pjesshme në Kolegjin Riinvest dhe në Universitetin e Prishtinës/ Nuk janë bërë kontrata paraprake për shumicën e anëtarëve të stafit.

Gjendja aktuale e burimeve njerëzore lidhur me kurrikulën e planifikuar të MSc nuk jep të dhëna të mjaftueshme për zbatueshmërinë e saj, ku mjaftueshëm akademikë dëshirojnë të ndërtojnë një kurrikul MSc tërësisht të re dhe konkurruese.

### **Rekomandime:**

**Do të këshillohej pasja e një grupi më të madh njerëzish që punojnë me kohë të plotë në UKZ dhe që mbulojnë lëndët bazë të kurrikulës së re. Sugjerohet gjithashtu renditja i stafit akademik/lektorëve të tjerë të planifikuar që mund të japin leksione brenda kurseve (jo vetëm personi përgjegjës). Këshillohet fort mbështetja e këtyre liderëve të rinj që eksperti takoi gjatë vizitës në terren për zhvillimin shtesë të programit.**

## *iii. Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar*

RVV shpreh (fq. 61) se “të gjitha kurset janë hartuar në mënyrë të tillë që reflektojnë rëndësinë e tyre në kontekstin e programit relevant të hulumtimit”. Sipas materialeve/informacionit shtesë të marrë nga UKZ “ata po punojnë në

këtë drejtim, por jo mjaftueshëm". Kësisoj, aktualisht nuk ka asnjë program hulumtimi. Stafi mësimor nuk është fokusuar ende mbi hulumtimin dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme për hulumtim akademik të prodhuar nga stafi. Veçanërisht në nivelin MA, kjo kërkesë duhet të marrë më shumë vëmendje.

**Rekomandime:**

Profili hulumtues i shkollës dhe aftësitë e hulumtimit janë të rëndësishme për një arsim dhe zhvillim institucional të qëndrueshëm veçanërisht në nivel Master. Pjesëmarrja dhe qasja në projekte hulumtuese ndërkombëtare nuk ekziston për momentin dhe do të inkurajohej shumë fillimi i aplikimeve të tilla/projekteve të përbashkëta të hulumtimit më aktivisht. Duhet caktuar koha për përgatitjen e aplikimeve të tilla dhe ndërtimin e lidhjeve ndërkombëtare. Do të ishte i rëndësishëm inkurajimi i stafit për mbarëvajtjen e aftësive të tyre përmes botimit të punës kërkimore në kontekst ndërkombëtar.

*Përfundim:* Programi duhet të ketë më shumë konsideratë dhe stafi do të kishte nevojë për më shumë kohë për t'u fokusuar në program dhe në audiencën/target grupin e duhur. Shumë aspekte kanë nevojë të marrin më shumë vëmendje dhe konsideratë para se të hapet program. Ka nevojë për zhvillime të mëtejshme për ndërtuar hulumtimin dhe kompetencat ndërkombëtare. Bazuar në këtë rrjedhimisht rekomandohet që programi të mos akreditohet këtë vit.

Nënshkruar. Prof.Dr.Dr.h.c.mult. Reinhard Meyers  
Tönnesson

Prof.Dr. Kristina